



Shtojca 3

Sqarime rreth derogimit të kodit të rrjetit, kodit të matjeve dhe obligimeve që dalin nga Licenca e Operatorit të Sistemit të Transmisionit

Kodi i rrjetit

Kodi Operativ

3.4.2 Mjetet e Komunikimit

3.4.2.2 - Për qendrat e kontrollit të OSSH-ve, trafostacionet 400kV dhe 220kV, **stabilimentet energjetike dhe përdoruesit e ngarkesës** të lidhur me 110kV ose më tepër, kërkohen dy linja të ndara komunikimi.

Arsyetimi i KOSTT

Përveq linjave telefonike statike, rruga tjetër e komunikimit duke shfrytëzuar Frekuencën e Lartë nuk është e implementuar në shumicën e trafostacioneve.

Kërkesa - 1 vit

Lejuar - 1 vit

5.5.3 Stabiliteti dhe Mbingarkesa e Rrjetit

5.5.3.2 - Në funksionim normal, sistemi ka karakteristikat e mëposhtme:

- Furnizon të gjithë konsumatorët;
- Vëzhgon të gjitha vlerat limituese (p.sh. s'ka mbingarkesa);
- **Kriteri (n-1)** plotësohet në të gjitha pikat

5.5.3.3 – Mbajtja e kriterëve të mësipërme do të sigurojë që për të gjitha ndodhitë e besueshme sistemi do të mbetet i qëndrueshëm dhe nuk do të provon mbingarkesat. OSTT do të kryejë studimet e sigurisë në baza rutinore dhe sipas rastit për të siguruar që siguria e sistemit arrihet dhe mbahet dhe për të kontrolluar çdo pengesë funksionimi të lidhur me kushtet e pazakonshme ose jonormale të funksionimit. Rezultatet e atyre studimeve do t'i komunikohen Rregullatorit në rast të një pengese serioze.

5.5.3.4 - Të gjithë elementet e **sistemit** të cilat janë nën rrezikun e dëmtimit si pasojë e mbingarkesës duhet të pajisen me mbrojtje kundër mbingarkesës. Këto nuk kërkohen për pajisjet që në afatin e shkurtër mund të shkarkohen nga veprimet e dispeçimit.

Arsyetimi i KOSTT

Për shkak të fyteve të ngushta në transformim dhe transmetim.

Linjat 110 kV nuk janë të pajisura me mbrojtjet mbirrymore.

Kërkesa - 1 vit

Lejuar - 1 vit

Kodi i balancit

2.4.2 Auditimi

2.4.2.1 - **OSTT** do të sigurojë që të gjitha **udhëzimet e dispeçimit** të mbahen në një formë elektronike në gatishmëri përdorimi për një periudhë prej të paktën 5 [pesë] vjetësh. Çdo **pjesëmarrës në treg** mund të kërkojë të ketë qasje në këtë informacion, vetëm në lidhje me **stabilimentin dhe aparatin** e vet, ose për



sa i përket një **udhëzimi dispeçimi** për një palë tjetër që ka pasur një ndikim të madh në asetet e tij. Kjo qasje do të lejohet vetëm me marrëveshjen e **OSTT** dhe **Rregullatorit** si rezultat i një kërkesë të arsyeshme.

2.4.2.2 - OSTT dhe të gjithë përdoruesit janë të detyruar të venë në dispozicion të gjitha shënimet e udhëzimeve të dispeçimit dhe ekzekutimit të tyre për qëllimet e një hulumtimi të përbashkët, mosmarrëveshjeve apo proceseve gjyqësore me kërkesën e autoriteteve përkatëse. Kur japin të dhënat ata do të marrin të gjitha masat e nevojshme për të ruajtur fshehtësinë e të dhënave aty ku është e nevojshme.

Arsyetimi i KOSTT

Ende nuk është krijuar baza e të dhënave në formë elektronike për ruajtjen e **Udhëzimeve të Dispeçimit**, përderisa nuk implementohet SCADA/EMS. **Udhëzimet e Dispeçimit** do të ruhen në formë të shkruar.

Kërkesa – 3 vjet

Lejuar - 1 vit

3.9 Programi i Tensionit

3.9.1.1 – Çdo [tre] muaj OSTT do të përgatisë një program të tensionit që përmban të paktën informacionin e mëposhtëm:

- Periudhën nën konsiderim;
- Mënyrën e funksionimit të **Sistemit të Transmisionit**;
- Pikën e caktuar të tensionit në pika të veçanta;
- Aranzhmanet e ndryshuesve të rregullatorit (Tap) të transformatorëve dhe autotransformatorëve;
- Kundërmasat që duhet të përshtaten në rastin e mosbalancimit të **fuqisë reaktive** mes ofertës (furnizimit) dhe **ngarkesës**;
- Ndonjë informacion tjetër të nevojshëm për rregullimin e tensionit dhe **fuqisë reaktive**.

Arsyetimi i KOSTT

Nuk realizohet vetëm pika (bulleti) e pestë për marrjen e kundërmasave në rastin e mosbalancimit të fuqisë reaktive mes furnizimit dhe ngarkesës.

Kërkesa - 1 vit

Lejuar - 1 vit

3.9.1.3 – **OSTT** do të monitorojë përmbushjen e programit të tensionit dhe udhëzimeve të **OSTT** nga ana e **përdoruesve** në lidhje me rregullimin e tensionit/**fuqisë reaktive**. Në rastet e mospajtueshmërisë **OSTT** ka të drejtë të ve në punë mjete të tjera për rregullimin e tensionit/**fuqisë reaktive** (p.sh bazuar në **marrëveshjet e shërbimeve ndihmëse**) në llogari të **përdoruesit** relevant që ka dështuar në ekzekutimin e detyrimit të tij.

Arsyetimi i KOSTT

Nuk realizohet për shkak të mungesës së marrëveshjeve për shërbime ndihmëse.

Kërkesa - 1 vit

Lejuar - 1 vit



4.4.3 Rregullimi Sekondar

4.4.3.7 – OSTT është i detyruar të marrë dhe të shpërndajë sinjale të rezervës së rregullimit sekondar për njësitë prodhuese (gjeneruese) që marrin pjesë në rezervën e rregullimit sekondar automatik.

Njësitë prodhuese (gjeneruese) gjatë ofrimit të këtij shërbimi janë të detyruara të ofrojnë përgjigje efikase, të sakta dhe të besueshme për këto sinjale.

Arsyetimi i KOSTT

Rregullimi sekondar momentalisht bëhet sipas një marrëveshje teknike nga EPS, ndërsa për mundësitë e rregullimit sekondar nga njësitë tona gjeneruese nuk ka ndonjë analizë/plan më të hollësishëm.

Kërkesa - 1 vit

Lejuar - 1 vit

Kodi i Planifikimit Operativ

3.4.3 Pengesat e Sistemit të Transmisionit

3.4.3.1 – OSTT do të jetë përgjegjës për përgatitjen dhe publikimin e parashikimeve të mëposhtme të vazhdueshme të pengesave në Sistemin e Transmisionit për Sistemin Energjetik të Kosovës – duke përfshirë interkoneksionet ndër-shtetërore – ose për çdo pjesë të tij, si pjesë e informacionit të vlerësimit të sigurisë:

- Çdo [tre] muaj një parashikim i pengesave të sistemit në Sistemin e Transmisionit për [një] vitin e ardhshëm sipas [javës];
- Çdo [muaj] një parashikim i pengesave të sistemit në Sistemin e Transmisionit për [tre] muajt e ardhshëm sipas [ditës];
- Çdo javë një parashikim i pengesave të sistemit në Sistemin e Transmisionit për çdo [21] ditët e ardhshme për çdo [orë];

Çdo ditë do të përgatitet parashikimi i kongjestionit për ditën e nesërme (DACF). Ky DACF do të përgatitet nga OSTT së bashku me TSO-të e tjera brenda UCTE për të përmbushur kërkesat e marrëveshjeve DACF të UCTE

Arsyetimi i KOSTT

Parashikimet e pengesave në Sistemin e Transmisionit bëhen por publikimet nuk bëhen. Është duke u shqyrtuar mundësia e publikimit.

Kërkesa - 6 muaj

Lejuar – 6 muaj

3.12 Vlerësimet e Sigurisë së Sistemit Energjetik

3.12.1 – PSSA Mujore

3.12.1.1 OSTT do të përgatisë dhe publikojë një PSSA mujore çdo muaj deri në ditën e [20] të muajit. Ai do të mbulojë periudhën një vjeçare që fillon në muajin që menjëherë pason publikimin. Informacioni që përmban PSSA mujore do të punohet me një zgjidhje prej një jave.

3.12.1.2 PSSA mujore duhet të mbulojë vitin në vazhdim dhe duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

- **Parashikimet e ngarkesës** – këto do të mbulojnë vitin në vazhdim me një zgjidhje [javore] dhe ditët e maksimumeve dhe minimumeve të **ngarkesës** me një zgjidhje për çdo [orë];



- Për çdo muaj kalendarik **kërkesa** mesatare për çdo orë për një mesatare për ditët e biznesit në atë muaj dhe të dhënat ekuivalente sa i përket ditës mesatare që nuk është **ditë biznesi** në secilin muaj;
- Kërkesat e parashikuara të rezervës në mënyrë që të përmbushin **standardet e sigurisë** për **sistemin energjetik** të Kosovës;
- **Gjenerimi** në dispozicion – kapaciteti total i pritshëm i **gjenerimit** në dispozicion duke bërë zbritjet për ndonjë **njësi prodhuese (gjeneruese)** apo **stabiliment energjetik** që kanë pengesa energjetike ose pengesa për arsye të tjera në baza [javore];
- Kërkesa maksimale e pritshme dhe kërkesa mesatare për çdo orë (secila në MW) në lidhje me çdo muaj të vitit kalendarik në vazhdim.
- Vlerësimet e humbjeve në transmision në GWh në baza [javore];
- Vlerësimet e pengesave në **sistem** në GWh me një zgjidhje [javore];
- Detajet e ndonjë situatë të projektuar ku **standardet e sigurisë** për **Sistemin Energjetik** të Kosovës do të shkelen:

3.12.1.3 OSTT do t'i vendosë PSSA-të mujore në dispozicion të të gjitha palëve dhe Rregullatorit në versione elektronike dhe do t'i publikojë ato në faqen elektronike të tij.

3.12.2 – PSSA-të sezonale

3.12.2.1 OSTT do të punojë dhe publikojë PSSA sezonale dy herë në vit në [Mars] dhe [Shtator]. Do të mbulojë vitin në vazhdim për sezonet e dimrit dhe verës kryesisht për kapacitetin e interkonekcionit. PSSA sezonale do të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

- Parashikimet e **ngarkesës** – një parashikim i **ngarkesës** maksimale dhe minimale në dimër dhe verë;
- Vlerësimet e kapacitetit transferues maksimal dhe minimal të **interkonekcionit** sipas sezonit;
- Detajet e ndonjë situatë të projektuar ku **standardet e sigurisë** për **Sistemin Energjetik** të Kosovës do të shkelen:

3.12.2.2 OSTT do t'i vendosë PSSA-të sezonale në dispozicion të të gjitha palëve dhe Rregullatorit në versione elektronike dhe do t'i publikojë ato në faqen elektronike të tij.

3.12.4 – E Përgjithshme

3.12.4.1 OSTT mund të përgatisë dhe publikojë versione shtesë të azhuruara të PSSA-ve mujore, sezonale ose javore në rastet e ndryshimeve të rëndësishme apo arsyeve të tjera që OSTT i konsideron të nevojshme.

3.12.4.2 OSTT duhet të dokumentojë procedurën e përdorur për përgatitjen e PSSA-ve mujore, sezonale dhe javore dhe ta vendosë këtë informacion në dispozicion të çdo pale dhe Rregullatorit.



Arsyetimi i KOSTT

Vlerësimet e Sigurisë së Sistemit bëhen por publikimet nuk bëhen. Edhe për këtë është duke u shqyrtuar mundësia e publikimit.

Kërkesa - 6 muaj

Lejuar – 6 muaj

Kodi i Matjes

8.2.1.6 - Matësit kryesor dhe kontrollues do të instalohen ashtu siç parashtrohet në tabelën e mëposhtme që gjithashtu tregon se ku duhet të vendosen TMRR dhe TMT të veçanta për të vënë në punë matësin kryesor dhe matësin kontrollues:

Arsyetimi i KOSTT

Me implementimin e projektit të Njehsorëve

Kërkesa - 6 muaj

Lejuar – 6 muaj

8.2.2.8 - Aty ku është praktike, bobinat (pështjellat) sekondare të TMT dhe TMRR të përdorura për qëllime matëse duhet të përdoren ekskluzivisht për qëllime matëse, megjithëse do të jetë e lejueshme të ndahet përdorimi i bobinave (pështjellave) me pajisje të tjera nëse kërkesat e seksioneve 8.2.2.7, 8.2.3.2 dhe 9 janë përmbushur dhe është marrë miratimi i Operatorit të Tregut. Sapo të jetë dhënë miratimi për përdorim të përbashkët nuk do të lejohet ndryshimi i ngarkesës në ndonjërin nga bobinat (pështjellat) e TMRR dhe TMT pa marrë përsëri miratimin e Operatorit të Tregut.

Arsyetimi i KOSTT

Me implementimin e projektit të Njehsorëve. Përveq për Linja interkonektive ku TM nuk disponojnë dy bërthama me karakteristika të njejta.

Kërkesa - 6 muaj

Lejuar – 6 muaj

11.4 Kalibrimi Periodik dhe Ripërtëritja

11.4.1.1 - Matësit elektromekanik dhe statikë do të testohen dhe ri-kalibrohen periodikisht dhe do të ripërtërihen sipas nevojave në intervale siç është vendosur në çertifikatën fillestare verifikuese ose siç është përcaktuar nga Ministria. Pas ripërtëritjes, matësit do të dorëzohen për riverifikim.

Arsyetimi i KOSTT

Pajisjet për kontrollimin dhe kalibrimin e njehsorëve akoma nuk janë siguruar (blerë).

Kërkesa - 6 muaj

Lejuar – 6 muaj

11.4.1.2 – Data dhe rezultatet e të gjitha testeve duhet të futen në regjistrin e matësve. Kohë pas kohe, mund të kërkohen teste speciale jashtë testeve të përcaktuara.

Arsyetimi i KOSTT

Mungon tavolina për kalibrimin e njehsorëve me saktësi të kërkuar sipas standardeve.

Kërkesa - 6 muaj

Lejuar – 6 muaj



Neni 9: Disponueshmëria dhe Mirëmbajtja e të Dhënave

4. I Licencuari është përgjegjës për mirëmbajtjen dhe publikimin e të dhënave të informacioneve për kapacitetet kufitare, në ndërlidhjet si dhe për të drejtat dhe detyrimet në lidhje me harduerin dhe softuerin e nevojshëm për kalkulimin e ngarkesës së rrjedhjes, menaxhimin e kongjestionit, planin e dispeçimit të kapacitetit, tregun balancues dhe atë ndihmës si dhe informatat tjera të ndërlidhura.

Arsyetime i KOSTT

Mirëmbajtja e të dhënave të informacioneve për kapacitetet kufitare bëhet por publikimi nuk bëhet për shkak të rrethanave të ndryshme. Poashtu nuk disponojmë me harduerin dhe softuerin e nevojshëm për kalkulimin e ngarkesës së rrjedhjes dhe menaxhimin e kongjestionit të cilat momentalisht bëhen me PSSE por nuk janë valide pa këmbimin e modeleve të TSO-ve fqinje e kjo është si pasojë e mospjesëmarrjes së KOSTT në Mekanizmat sikurse ITC/CBT, Menaxhimin e Kongjestionit etj.

Kërkesa - 6 muaj

Lejuar – 6 muaj

11. Operimi i Sistemit

11.1. I Licencuari do të nxjerrë udhëzime direkte për dispeçimin e të gjitha njësive të gjenerimit që janë në dispozicion të çdo gjeneruesi të rëndësishëm në territor, sipas programimit dhe njoftimit me shkrim të dhënë nga gjeneruesit dhe furnizuesit, dhe më pas i Licencuari do të kryejë mekanizmin balancues (kërkesë dhe furnizim) në përputhje me Rregullat e Tregut.

11.2. (d,h,i) I Licencuari do të ndërmarr planifikim operativ dhe do të nxjerrë udhëzime direkte për dispeçin e këtyre njësive gjeneruese, duke marrë parasysh njoftimet me shkrim të referuara në paragrafin 1 dhe faktorët në vazhdim:

- a) parashikimin e kërkesave;
- b) kufizimet teknike të vendosur kohë pas kohe në të gjithë sistemin ose në ndonjë pjesë të tij;
- c) karakteristikat e dinamikës operuese të njësive të prodhimit dhe transferit të linjës së ndërlidhjes;
- d) [parashikimet e eksporteve dhe importeve të energjisë elektrike përgjatë çdo linje të ndërlidhjes;](#)
- e) humbjet gjatë transmisionit;
- f) ndërprerjet e sistemit të transmisionit për mirëmbajtje, riparim, zgjerim ose përforsim;
- g) [standardet Operuese të Sigurisë, të cilat janë referuar në Nenin 16 të kësaj Licence;](#)
- h) [mekanizmit balancues në përputhje me Rregullin e Tregut;](#)
- i) [dhënien e kapaciteteve të transmisionit në mënyrë jo diskriminuese;](#)
- j) energjia elektrike e dërguar në sistemin e transmisionit nga blloqet e gjenerimit që nuk i nënshtrohen dispeçimit qëndror; dhe
- k) çështje të tjera që përcaktohen në Kodin e Rrjetit Elektrik.

Arsyetime i KOSTT

Për shkak të mosfunksionimit të Rregullave të Plota të Tregut, nuk mund të realizohet komplet ky Nen.

Kërkesa – 1 vit

Lejuar – 1 vit